

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PaKr 503/13

Data: 27 Maj 2014

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, me trupin gjykses të përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it, Manuel Soares si gjyqtar kryesues dhe raportues, të Gjyqtarës së EULEX-it Annemarie Meister dhe të Gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Xhevdet Abazi si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Juridik të EULEX-it, Andres Parmas si procesmbajtës, në lëndën penale kundër

Jovica DEJANOVIC, i liruar në shkallën e parë nga veprat penale të **Krimit të Luftës kundër Popullatës Civile**, sipas Neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative e Jugosllavisë (KP RSFJ-së), aktualisht e ndjekur penalisht nga Nenet 31 dhe 153 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) dhe **Mbajtje në Pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, sipas Nenet 328 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPK-së), aktualisht e ndëshkuar nën Nenin 374 të KPRK-së;


Djordje BOJKOVIC, i dënuar në shkallën e parë për veprën penale të **Mbajtjes në Pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, sipas Nenet 328 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPK-së), aktualisht e ndëshkuar nën Nenin 374 të KPRK-së, dhe i liruar në shkallën e parë për veprën penale të **Krimit të Luftës kundër Popullatës Civile**, sipas Neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative e Jugosllavisë (KP RSFJ-së), aktualisht e ndjekur penalisht nga Nenet 31 dhe 153 të KPRK-së;

Duke vepruar në Ankesën e Avokatit Mbrojtës Miodrig Brkljac, e dorëzuar më 31 Tetor 2013, dhe të ankesës së përbashkët të Prokurorëve pranë PSRK-së, Erik Larson dhe Diana Wilson kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës me nr. P 946/13 më 31 Tetor 2013;

Pas marrjes në konsideratë të përgjigjeve kundrejt ankesës së Prokurorëve nga ana e Avokatit Mbrojtës Ljubomir Pantovic në emër të J. Dejanovic e dorëzuar më 19 Nëntor 2013 dhe nga Avokati Mbrojtës, M. Brkljac në emër të D. Bojkovic e dorëzuar më 19 Nëntor 2013;

Gjithashtu pas marrjes në konsideratë të mendimit të Prokurorit të Apelit pranë Zyrës së Prokurorisë së Shtetit, nr. PPA/I.KTŽ/13, e datës 20 Janar 2014 dhe e dorëzuar më 21 Janar 2014;

Pas mbajtjes të një seance publike më 27 Maj 2014, ku të gjitha palët ishin thirrur në mënyrë të rregullt, në prezencë të Prokurorit të Apelit K. Lamberg dhe Avokatëve Mbrojtës L. Pantelic në emër të J. Dejanovic dhe M. Brkljac në emër të D. Bojkovic;



Pas këshillimit dhe votimit më 27 Maj 2014,

Në mbështetje të Nenit 398 dhe sipas Kodit të Procedurës Penale (KPP-së)
Vendosi si më poshtë

AKTGJYKIM

1. Ndryshohet në këtë mënyrë Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës, në lëndën me nr. P 13/2013, i datës 17 Prill 2013 si në vijim:
 - 1) Duke zbatuar Ligjin mbi Amnistin, aktakuza refuzohet në pjesën ku Djordje Bojkovic është akuzuar me veprën penale të Mbajtjes në Pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me Nenit 328 (2) të KPK-së (aktualisht Neni 374 i KPRK-së);
 - 2) Anulohet lirimi i Jovica Dejanovic dhe i Djordje Bojkovic nga vepra penale e Krimit të Luftës kundër Popullatës Civile nën Nenin 142 të KP RSFJ-së;
 - 3) Jovica Dejanovic është dënuar për veprën penale të Krimit të Luftës kundër Civilëve (dhunim i V. K██████████), sipas Nenit 142 të KP RSFJ-së (tani neni 153 i KPRK-së) sepse ai, në cilësinë e tij si një Oficer Policie Serb, gjatë periudhës kohore të konfliktit të armatosur në Kosovë, më 14 Prill 1999, ka rrëmbyer dhe dhunuar V██████████ K██████████, një shqiptare civile të Kosovës, duke e vozitur atë në një vend të panjohur afër Babin Most, dhe duke e detyruar atë, ndërkohë që ishte i armatosur me një pushkë dhe duke e kërcënuar atë me një thikë, që të kryente lloje të ndryshme të marrëdhënieve seksuale brenda makinës së tij, kundër pëlqimit të saj;
 - 4) Djordje Bojkovic është dënuar për veprën penale të Krimit të Luftës kundër Civilëve (dhunim i V. K██████████), sipas Nenit 142 të KP RSFJ-së (tani neni 153 i KPRK-së) sepse më 14 Prill 1999, ka dhunuar V██████████ K██████████, një shqiptare civile të Kosovës, e cila ishte rrëmbyer nga një Oficer Police Serb, Jovida Dejanovic, duke qenë në posedim të një pistolete, dhe duke e dërguar atë në një shtëpi të pambaruar në Babin Most, duke e hedhur atë për tokë, dhe duke e detyruar që të kryente marrëdhënie seksuale kundër pëlqimit të saj;
 - 5) Jovica Dejanovic është dënuar me 12 vjet burg;
 - 6) Djordje Bojkovic është dënuar me 10 vjet burg;
 - 7) Në pjesën e mbetur, Aktgjykimi i Sfiduar i Gjykatës së Shkallës së Parë, konfirmohet.
2. Miratohet pjesërisht Ankesa e Prokurorit Special.
3. Miratohet pjesërisht Ankesa e Avokatit Mbrojtës Miodrag Brkljac në emër të të Pandehurit Djordje Bojkovic.
4. Që të dy të Pandehurit, Jovica Dejanovic dhe Djordje Bojkovic, duhet që të kompensojnë 250 (dy qind e pesëdhjetë) Euro si pjesë e shpenzimeve të procedurave penale, por lirohen nga detyrimi për të kompensuar pjesën e mbetur të shpenzimeve, sipas Nenit 453 (1) dhe (4) të KPP-së.
5. Refuzohet nga ana e Gjykatës së Apelit kërkesa e Prokurorit Special të datës 20 Shkurt 2014, për të dorëzuar dëshmi plotësuese.

ARSYETIMI

I. Historia Procedurale e lëndës

Më 12 Nëntor 2012, Zyra e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës dorëzoi Aktakuzën PPS nr. 89/2012 kundër të akuzuarve tek ish-Gjykata e Qarkut në Mitrovicë. Më 26 Nëntor 2012, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë lëshoi një Aktvendim për të ndryshuar aktakuzën. Më 30 Nëntor 2012, Prokurori paraqiti aktakuzën e ndryshuar.

Më 5 Shkurt 2013, Gjykata Themelore e Mitrovicës lëshoi një vendim ku refuzoi kërkesën e Mbrojtjes për të hedhur poshtë aktakuzën, dhe kundërshtimet e Mbrojtjes mbi pranueshmërinë e provave. Ky vendim është vërtetuar nga aktvendimi i lëshuar nga ana e Gjykatës së Apelit më 6 Mars 2013.

Shqyrtimi Kryesor për lëndën në fjalë është mbajtur ndërmjet datave 4 dhe 15 Prill 2013. Aktgjykimi është shpallur më 17 Prill 2013. Jovica Dejanovic është liruar për të gjitha akuzat. Në mbështetje të Nenit 115 (1) dhe (2) të KPP-së, në lidhje me Nenet 38 dhe 2 (1.42) të Ligjit për Armët, fishekët me kalibër prej 9 mm, të gjetura gjatë bastisjes së shtëpisë të Pandehurit J. Dejanovic, janë konfiskuar. Djordje Bojkovic është liruar nga akuza e Krimin të Luftës kundër Popullatës Civile (dhunim) e dënueshme sipas Neneve 22 dhe 142 të KP RSFJ-së. D. Bojkovic është shpallur fajtor për veprën penale të **Mbajtjes në Pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve**, sipas Nenit 328 të (KPK-së), aktualisht e ndëshkuar nën Nenin 374 të KPRK-së). Ai u dënua me 1 vit dhe gjashtë muaj burg. Dënimi u pezullua për një periudhë verifikuese prej 2 vjetësh. Në mbështetje të Nenit 374 (3) të KPRK-së, pistoleta automatike M-70 AB2, karikatorët dhe 69 fishekë municion, të gjetura gjatë bastisjes së shtëpisë të pandehurit D. Bojkovic, janë konfiskuar. Shpenzimet e procedurave penale janë urdhëruar për tu paguar nga burimet buxhetore në lidhje me të akuzuarin Dejanovic. Të akuzuarit Bojkovic, i është caktuar për të paguar shuma prej 100 Euro si pjesë e shpenzimeve, dhe është liruar nga detyrimi për të paguar pjesën e mbetur të shpenzimeve.

Gjykata Themelore konstatoi gjatë shqyrtimit kryesor se më 13 Prill 1999, disa burra, të veshur me uniformë, kanë shkuar tek shtëpia ku V. K. jetonte me anëtarët e tjerë të familjes së saj, dhe ku në atë kohë ishin duke qëndruar shumë refugjatë. Këto burra me uniformë i urdhëruan refugjatët që të largoheshin. Është konstatuar që në ditën tjetër, njëri nga burrat, i veshur me uniformë, ka ardhur përsëri në shtëpi, dhe përmes kërcënimeve me një armë zjarri, ka detyruar V. K. që të shkonte me të në një makinë të parkuar jashtë portës së shtëpisë, dhe pastaj ka vozitur makinën. Gjykata Themelore, gjithashtu ka konstatuar se pak më vonë rrëmbyesi ka dhunuar viktimën dhe pastaj një burrë tjetër ka dhunuar atë edhe një herë.


Megjithatë, Gjykata Themelore nuk ka konstatuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të Pandehurit kanë qenë personat që kanë kryer aktet e mësipërme. Trupi Gjykues, pas një analize të gjerë të rreshtit fotografik ku i Pandehuri J. Dejanovic ishte njohur nga viktima dhe dëshmitarët H. K. [REDACTED], N. K. [REDACTED], M. K. [REDACTED] dhe I. G. [REDACTED]; dhe rreshti fotografik i D. Bojkovic, ku ky i Pandehur është identifikuar në mënyrë pozitive nga ana e viktimës, arriti në përfundimin se asnjë nga protokollet e rreshtit fotografik, nuk janë prova të besueshme. Kritika kundër rezultateve të rreshtit fotografik mbështetet si në vijim.

Fotografitë e personit që Pala e Dëmtuar i ka identifikuar në Tetor 1999, nuk mund të gjenden apo të identifikohen si të shënuara në shkresat e lëndës. Gjithashtu nuk ka prova që të tregojnë se si është kryer ky identifikim i rreshtimit fotografik, nëse ky ishte në përputhje me normat e zbatueshme të procedurës penale në atë kohë. Gjatë shqyrtimit kryesor, Gjykata ka kontrolluar kopjet bardh e zi të dy fotografive të zgjedhura nga ana e viktimës gjatë identifikimit të parë të rreshtit fotografik, por në asnjërën prej tyre, personi nuk i ngjanë të Pandehurit J. Dejanovic. Gjykata Themelore konstatoi se identifikimi i pasaktë ka zvogëluar besueshmërinë e identifikimeve të mëvonshme, dhe ka pasur gjasa që të kontaminonte kujtesën e viktimës, kështu që në identifikimet e mëvonshme, ajo mund të mos kishte njohur autorin e vërtet, por vetëm personin që ajo ka njohur gjatë procedurës së parë të identifikimit.

Identifikimi i J. Dejanovic nga ana e dëshmitarëve H. K. [REDACTED], N. K. [REDACTED], M. K. [REDACTED] dhe I. G. [REDACTED] ishte konsideruar si i pabesueshëm nga Gjykata e Shkallës së Parë, sepse dëshmitarët e kanë parë autorin vetëm përkohësisht, dhe që kishte kaluar një kohë e gjatë nga ngjarja, kur është bërë identifikimi, dhe sepse dëshmitarët janë prej së njëjtës familje, dhe mund të kenë diskutuar me njëri-tjetrin identitetin e mundshëm të autorit. Gjykata e Shkallës së Parë, gjithashtu konstatoi të metat gjatë kryerjes aktuale të identifikimit, meqenëse dëshmitarët nuk ishin udhëzuar që fotografitë e autorit mund apo nuk mund të përfshihen në kompletin e identifikimit, dhe se ato nuk ishin të detyruar për të zgjedhur ndonjë person apo fotografi. Oficerët e Policisë, të cilët kanë hartuar raportin e identifikimit nga viktima, kanë qenë të pranishëm gjithashtu gjatë identifikimit nga dëshmitarët H. K. [REDACTED], N. K. [REDACTED] dhe I. G. [REDACTED]. Prandaj, ka shumë gjasa se këto hetues kanë qenë vetë në dijeni të identitetit të të dyshuarve dhe nuk mund të përjashtohet mundësia se dëshmitarët kanë qenë të ndikuar gjatë procedurës së identifikimit.

Për sa i përket identifikimit të J. Dejanovic nga ana e M. K. [REDACTED], Gjykata theksoi se ajo kishte dëgjuar dikën duke folur Serbisht në një dyqan në vitin 2010, *d.m.th.* 11 vjet pas ngjarjes dhe ka lidhur zërin që ajo dëgjoji me personin që kishte rrëmbyer V. K. [REDACTED]. Kur identifikimi i fotografisë është kryer pas kësaj ngjarje, nuk mund të përjashtohet që dëshmitari vetëm ka identifikuar personin që ajo ka parë në dyqan. Nuk ka siguri se kur fotografia e J. Dejanovic e përdorur në rreshtin fotografik është bërë, që ngre dyshime në identitetin real të kryerësit. Gjithashtu, përshkrimet e kryerësit i dhënë nga dëshmitarët nuk mbështesin një konkluzion që kryerësi është J. Dejanovic.

Ajo që ka të bëjë me identifikimin e të Pandehurit D. Bojkovic nga ana e viktimës, Gjykata e Shkallës së Parë mori qëndrimin që besueshmëria e këtij identifikimi është penguar nga fakti që vetëm njëra fotografi e treguar viktimës i ngjante këtij të Pandehuri.



Gjykata e Shkallës së Parë konstatoi se asnjë dëshmi tjetër e vlerësuar gjatë shqyrtimit kryesor nuk ka hequr dyshimet që tregojnë nëse J. Dejanovic ishte personi që ka rrëmbyer V. K. [REDACTED], apo nëse J. Dejanovic dhe D. Bojkovic janë kryerësit e dhunimit.

Për sa i përket akuzës së pronësisë së paautorizuar të nëntë fishekëve me kalibër prej 9 mm, të gjetur në shtëpinë e J. Dejanovic, Trupi Gjykues konstatoi se fishekët ishin të të Pandehurit, dhe në fakt ato ishin në posedimin e tij. Megjithatë, Gjykata nuk ka konstatuar që posedimi i këtyre fishekëve ishte i paautorizuar, sepse J. Dejanovic punonte se një oficer policie, dhe se atij i lejohej që të mbante armën e tij të shërbimit për 24 orë në ditë. Nuk ka prova që tregojnë se fishekët e konfiskuar nuk i përkisnin armës së tij zyrtare.

Në lidhje me akuzën e pronësisë së paautorizuar të një arme automatike e llojit M-70 AB2, e konfiskuar nga shtëpia e të Pandehurit D. Bojkovic, Trupi Gjykues konstatoi se arma ishte në fakt në posedim të të Pandehurit dhe deklarata e të Pandehurit, ku deklaroi se nuk dinte gjë për armën, nuk është i besueshëm.

II. Parashtrësit e palëve

1. Ankesat e Prokurorëve

Më 31 Tetor 2013, Prokurorët e PSRK-së dorëzuan një Ankesë të Përbashkët duke propozuar që aktgjykimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të ndryshohet ku J. Dejanovic dhe D. Bojkovic të dënohen për veprën penale të Krimin të Luftës kundër Popullatës Civile, ose përndryshe që të dërgoj lëndën për rigjykim tek Gjykata e Shkallës së Parë. Ankuesit pohojnë se Trupi Gjykues ka konstatuar gjendjen faktike në mënyrë jo të plotë dhe të gabuar, dhe se Aktgjykimi i Sfiduar është arritur duke shkelur esencialisht dispozitat e procedurës penale.

Prokurorët argumentojnë se Gjykata Themelore në mënyrë të gabuar nuk ka përcaktuar drejtë se viktima ishte dhunuar nga të Pandehurit. Dyshimet për identitetin e kryerësit janë krijuar vetëm në mënyrë artificiale dhe të pajustificueshme nga ana e Trupit Gjykues. Vlerësimi nga Trupi Gjykues i rezultateve të rreshtit fotografik është i gabuar dhe i pajustificueshëm. Trupi Gjykues gjithashtu shpjegoi kriterin për të përmbushur këto standarde në organizimin e rreshtin fotografik, të cilat nuk kërkohen nga ligji i procedurës penale të Kosovës, dhe i bënë të paqëndrueshme referencat për të studiuar psikologjinë e dëshmitarit, pa iu referuar në ndonjë burim konkret për këtë. Prokurorët janë të mendimit se nëse dëshmitarët ishin në gjendje të njohin kryerësin pa hezitim nga rreshti fotografik, jo vetëm pas një periudhe të shkurtë pas ngjarjes por edhe pas 13 vjetëve, kjo rrit besueshmërinë e kësaj njohje në mënyrë të konsiderueshme. Ka prova të forta dhe vërtetuese që J. Dejanovic dhe D. Bojkovic kanë kryer krimin e luftës që janë të akuzuar. Prokurorët gjithashtu paraqesin se prova të reja materiale vërtetuese në formën e raporteve Verifikuese të Misionit OSBE në Kosovë të cilat dëmtojnë deklaratën e J. Dejanovic që nuk ka qenë në fshatin ku viktima banonte afër kohës së kryerjes së veprës, d.m.th. në Prill 1999.

Ankuesit gjithashtu pohojnë se Trupi Gjykues ka shkelur thelbësisht dispozitat e procedurës penale duke kërkuar kriterë plotësuese të procedurës së rreshtimit fotografik, që nuk janë të

përcaktuara në Nenin 255 të KPPK-së (tani Neni 120 të KPP-së). Në këtë mënyrë Trupi Gjykses gabimisht e injoron prokurorinë që fotografia e të dyshurit duhej t'i kishte ngjarë pamjes së tij në kohën e veprës penale, dhe fotografitë referencë duhej t'i ngjanin përshkrimit të bërë nga dëshmitari për kryerësin po ashtu; që fotografitë duheshin të prezantoheshin një nga një; dhe se personi që kryente procedurën nuk duhej të njihete se kush ishte i dyshuari.

Ankuesit janë të mendimit se Aktgjykimi i Sfiduar nuk është i nënshkruar nga personat e përcaktuar në KPP. Zyrtari ligjor i EULEX-it që ka nënshkruar Aktgjykimin në cilësinë e bashkëpunorit, nuk mund të konsiderohet si një procesmbajtës, sepse ajo në fakt nuk ka mbajtur procesverbalin e seancave të shqyrtimit kryesor. Gjithashtu, Trupi Gjykses ka shtrembëruar shënimet e shqyrtimit kryesor në Aktgjykim duke mohuar apo keqprezantuar faktet që janë shënuar gjatë seancës.

Më 20 Shkurt 2014, Prokurori paraqiti prova plotësuese tek Gjykata Themelore e Mitrovicës, 3 kopje të një CD-je që përmbante deklaratat e mbledhura nga OSBE, që demonstronte se anëtarët e njësisë policore rezervë të Dejanovic kanë qenë të pranishëm në Donjë Stanovcin e Poshtëm gjatë periudhës që viktima është rrëmbyer dhe dhunuar. Ajo pohon se kjo provë zhvlerëson tregimin e Dejanovic në lidhje me vendndodhjen e njësisë së tij në Prill 1999. Provat e reja të propozuara nuk mund të prezantoheshin më herët ashtu siç është shpjeguar tashmë në Ankesë të Prokurorit.


2. Përgjigjet mbi Ankesën e Prokurorëve

Avokati Mbrojtës i të Pandehurit J. Dejanovic, dorëzoi një përgjigje mbi Ankesën, që mbanë datën 15 Nëntor 2013, duke propozuar që të refuzoj Ankesën e Prokurorit si të pabazuar dhe të confirmoj Aktgjykimin e Sfiduar të Gjykatës Themelore në pjesën që ka të bëjë me të Pandehurin J. Dejanovic.

Ai kundërshton Ankesën duke theksuar se në kundërshtim me atë që është shkruar në ankesën e Prokurorisë, identifikimi i J. Dejanovic dhe të gjithë dëshmitarët e prokurorisë kanë qenë shumë të pasigurtë dhe kundërthënës, me plot kundërshtime, duke dhënë analizë të hollshme të këtyre deklaratave në parashtresën e tij. Avokati Mbrojtës po ashtu thekson se identifikimi i J. Dejanovic përmes rreshtit fotografik është plotësisht i papranueshëm dhe konkludon se Gjykata Themelore kishte të drejtë kur konstatoi se identifikimi i J. Dejanovic ishte i pabesueshëm.

Në lidhje me shkeljet esenciale të procedurës penale, Avokati Mbrojtës argumenton se pohimet e Prokurorisë për këtë janë arbitrare dhe jo të drejta. Edhe nëse kishte disa shkelje të procedurës, ato kanë qenë vetëm relative, dhe jo esenciale, dhe pa dyshim jo aq sa që do të bënte aktgjykimin të paplotë. Më tej, Avokati Mbrojtës pohon se plotësimet në ankesë, raporti i OSBE-së tregon vetëm se Prokurori nuk ka ndonjë lloj prove kundër J. Dejanovic.

Avokati Mbrojtës i të Pandehurit D. Bojkovic, paraqiti një përgjigje të datës 15 Nëntor 2013, duke propozuar që të refuzoj si të pabazuar Ankesën e Prokurorit në pjesën që ka të bëjë me D. Bojkovic, dhe të vërtetoj Aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.



Ai pohon se Ankesa e Prokurorit nuk respekton standardin themelor juridik që një dënim kërkon prova, të cilat vërtetojnë përtej dyshimit të arsyeshem se i akuzuari ka kryer veprën penale.

Çështja kryesore në këtë lëndë ishte besueshmëria e identifikimit dhe gjykata e shkallës së parë në Aktgjykimin e Sfiduar ka dhënë arsye të qarta dhe të forta se pse identifikimi nuk ishte i qëndrueshem në lëndën e D. Bojkovic. Ai argumenton se Prokuroria nuk merret me kundërshtimet në deklaratat e viktimës sepse nuk i përshtatet prokurorisë, dhe kjo është se pse në ankesë – përsëri – Prokurori pohon vetëm se viktima pa hezitim ka përshkruar Bojkovic. Ai më tej i referohet fjalës së tij përfundimtare dhe diskuton paqëndrueshmërinë e përshkrimit të D. Bojkovic nga ana e viktimës dhe dëshmitarve.

3. Ankesa e Avokati Mbrojtës në emër të të Pandehurit D. Bojkovic

Avokati Mbrojtës paraqiti një Ankesë në emër të të Pandehurit D. Bojkovic që mbanë datën 29 Tetor 2013, duke propozuar që akuzat kundër klientit të tij të refuzohen për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit të Amnistisë. Ankuesi pohon se sipas Neneve 2.1 dhe 3 të Ligjit mbi Amnistin/Ligji me Nr. 04/L-209, vepra penale e pretenduar e D. Bojkovic përfshihet nga amnistia. Prandaj procedurat penale kundër klientit të tij duhet që të pushohen. Shpenzimet e procedurave penale në lidhje me D. Bojkovic duhen që të mbulohen nga fondet publike.

4. Mendimi i Prokurorit të Apelit

Prokurori Publike i Apelit i kërkon Gjykatës së Apelit që të miratoj ankesën e Prokurorëve Special dhe të ndryshoj Aktgjykimin e Sfiduar siç është propozuar nga ata, ose të anuloj atë pjesë të Aktgjykimit dhe të kthej lëndën për rigjykim. Ai më tej propozon që të refuzoj Ankesën e Avokati Mbrojtës në emër të të Pandehurit D. Bojkovic, përveç të asaj në lidhje me dënimin që duhet të anulohet duke u mbështetur në Ligjin mbi Amnistinë. Arma dhe fishekët e sekuistruar duhen që të konfiskohen.

Prokurori i Apelit pajtohet me arsyetimin e dhënë në ankesë nga ana e Prokurorëve Special në lidhje me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike. Ai mendon se identifikimi i të pandehurve J. Dejanovic dhe i D. Bojkovic është kryer në mënyrë të besueshme dhe në pajtim me rregulloret në fuqi në atë kohë. Konstatimet e Gjykatës në aktgjykim nuk janë të justifikueshme në këtë aspekt.

Prokurori i Apelit po ashtu pajtohet me arsyetimin e Prokurorëve Special që interpretimi i gabuar i procedurës së identifikimit është një shkelje esenciale e procedurës penale; megjithatë, problematika me procesmbajtësin është një shkelje formale, dhe jo substanciale.

Ai pjesërisht pajtohet me ankesën e Avokatit Mbrojtës të të Pandehurit Bojkovic që Ligji mbi Amnistinë – që ka hyrë në fuqi pasi që aktgjykimi i shkallës së parë ishte shqiptuar- duhet të aplikohet në lidhje me akuzën e armës (Pika 2). Pohimi i Avokatit Mbrojtës që provat në lidhje me këtë akuzë nuk janë vlerëuar në mënyrë të duhur nga ana e gjykatës, nuk gëzon ndonjë meritë.



Në lidhje me kërkesën për të pranuar prova plotësuese, Prokurori i Apelit paraqet një kërkesë ku i kërkon Gjykatës së Apelit të miratoj parashtrësën e Prokurorit.

III. Konstatimet e Gjykatës së Apelit

1. Ligji Procedural i zbatueshëm

16. Ligji Procedural i aplikueshëm në këtë lëndë penale respektive është Kodi i ri i Procedurës Penale të Kosovës (KPP-ja), që ka hyrë në fuqi më 1 Janar 2013 sipas Nenit të saj 549.

2. Të gjeturat mbi meritat

2.1. E përgjithshmja

Gjykata e Apelit mbanë qëndrimin se çështjet e ngritura në ankesa meritojnë një vëmendje të hollsishtme. Megjithatë, para se të filloj për të elaboruar mbi meritat e ankesës, parashtrësja e Prokurorit Special e datës 20 Shkurt 2014, ku është kërkuar që provat plotësuese të pranohen nga Gjykata e Apelit, duhet të shqyrtohet. Prandaj, Prokurori i referohet paragrafit 18 të Ankesës së Prokurorëve, ku janë cekur provat e reja të propozuara, por gjithashtu theksoi se akoma nuk është marrë përgjigje në kohën e dorëzimit të Ankesës, mbi kërkesën për ndihmë ndërkombëtare juridike nga GJNKJ-ja, për të siguruar formalisht këto deklarata.

Parashtrësja e Prokurorit Special duhet të refuzohet për arsyet si në vijim. Sipas Nenit 382 (3) të KPP-së, prova të reja mund të prezantohen në ankesë, por ankuese duhet që jap arsye se pse ato nuk janë prezantuar më parë. Prokurorët në fakt kanë shpjeguar në paragrafin 17 të Ankesës se provat janë zbuluar nga Prokuroria vetëm pas lëshimit të Aktgjykimit në këtë lëndë. Gjykata e Apelit konstaton këtë shpjegim si jo të përshtatshëm. Provat mund të merren si të reja dhe mund të prezantohen edhe pas fillimit të gjykimit, nëse ekzistojnë arsye objektive se pse këto prova nuk mund të kishin qenë zbuluar më herët nga ana e Prokurorisë. Kjo mund të ketë ndodhur, p.sh. nëse një dokument i ri është gjetur, që ka rëndësi tek rasti, por ekzistenca e përmbajtjes të së cilit nuk është zbuluar më parë; apo nëse del ndonjë dëshmitar i ri, që nuk mund të jetë pritur në mënyrë të arsyeshme të identifikohet më përpara nga Prokuroria. Megjithatë, ky nuk është një rast i tillë, kur Prokuroria vetëm nuk ka marrë në konsideratë provat ekzistuese dhe të disponueshme. Misioni i Verifikimit në Kosovë (MVK-ja) ka operuar në vitin 1999, dhe raporti i saj është botuar tashmë në Nëntor 1999, siç është referuar tashmë nga vetë Ankuesit. Nuk mund të thuhet se informacioni në këto raporte publike të disponueshme, mund të jetë një informacion i ri që është zbuluar nga ana e Prokurorisë vetëm në vitin 2013. Prandaj, parashtrësja është e vonuar. Provat e reja të propozuara, gjithashtu do të ishin të papranueshme, sepse nuk i përmbushin kriteret e përcaktuara nga KPP-ja për deklaratat e dëshmitarit. Fragmentet e propozuara të deklaratave janë marrë nga persona të panjohur dhe ato nuk janë shënuar në një mënyrë të pranueshme sipas normave të aplikueshme procedurale në kohën kur janë marrë këto deklarata. Deklaratat janë dhënë nga persona pa ndonjë pozitë procedurale në procedurat në vazhdim dhe kështu që ato nuk i plotësojnë kushtet e deklaratave të dëshmitarit siç përcaktohen në Nenet 123 dhe 261 të KPP-së, apo të normave respektive të LPP, RSFJ-së, që ka qenë në fuqi në kohën kur janë mblodhur deklaratat.

2.2 Amnistia

Gjykata e Apelit pajtohet me Ankesën e Avokatit Mbrojtës të të Pandehurit D.Bojkoviq se sipas Ligjit mbi Amnistinë Nr. 04/L0-209 (Ligji mbi Amnistisë) akuza e D. Bojkoviqit pas kryerjes së veprës penale veprën penale sipas Nenit 328 (1) të KPK-së duhet të hedhet poshtë si dhe të përfundohet procedura penale. Ligji mbi Amnistinë është shpallur nga Presidentja e Republikës së Kosovës më 18 Shtator 2013 dhe është bërë publik në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 39 më 19 Shtator 2013. Kështu që ligji hyri në fuqi më 4 Tetor 2013. Në pajtim me Nenin 2(1) të Ligjit mbi Amnistinë të gjithë kryerësit e veprave të renditur në Nenin 3 të këtij Ligji për veprat që janë kryer para 20 Qershorit 2013 duhet të garantohen përjashtim i plotë nga çfarëdo ndjekje penale ose nga ekzekutim i dënimit për vepra të tilla, në pajtim me kushtet e Nenit 3 të këtij ligji. Sipas Nenit 3, (1.2.5) , gjithashtu vepra penale për mbajtje në kontroll, posedim, pronësi të armëve në kundërshtim me Nenin 328 (2) të KPK-së (tani Neni 374 i KPRK-së), bie nën fushën e amnistisë. Për shkak se D. Bojkoviq ka kryer veprën penale të armë mbajtjes pa leje para datës së paraparë në Nenin 2 (1) të Ligjit mbi Amnistinë, ai duhet të përjashtohet nga ndjekja penale për sa i përket këtij krimi.

Për arsyet si më lartë si dhe duke u bazuar në Nenin 363 (1.3) të KPK-së Gjykata e Apelit hedhë poshtë veprën penale të mbajtjes në kontroll, posedim, pronësi të armëve në kundërshtim me Nenin 328 (2) të KPK-së kundër D.Bojkoviqit.

2.3 Vërtetimi i Gabuar i Fakteve

Gjykata e Shkallës së Parë, konstatoi shkurtimisht se viktimat V [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] ishte vizituar më 13 Prill 1999 në vendbanimin e saj, në Stanovc, ku ajo jetonte me familjen e saj dhe ku, shumë refugjatë ishin duke qëndruar, nga disa burra të veshur me uniforma, të cilët i urdhëronin refugjatët të largoheshin. Në mbrëmjen e së nesërme, njeri nga po të njëjtit njerëz, i veshur me uniform dhe duke mbajtur armë, u kthye aty dhe e mori atë kudër vullnetit të saj, nën kërcënim, dhe e dërgoi atë me veturë në rrethinën e fshatit Babin Most, ku e dhunoi atë në vagjinë, gojë dhe anus, brenda në veturë. Më vonë, të njëjtën ditë, ajo u dërgua nga disa persona në fshatin Babin Most, ku një burrë tjetër e mori atë dhe e dërgoi në një shtëpi të papërfunduar dhe nën kërcënim të revoles e dhunoi atë në vagjinë dhe nga mbrapa. Pas këtyre ngjarjeve, të dy burrat e përmendur e kthyen atë në shtëpi. Kjo situatë faktike ishte vërtetuar nga Gjykata e Shkallës së parë, duke u bazuar në provat e ekzaminuara të përshkruara në aktgjykim dhe nuk ishte sfiduar nga asnjëra nga ankesat. Gjykata e Apelit pajtohet me këto konstatime dhe me vërtetimin e situatës faktike të përshkruar në më shumë detaje në paragrafët 28 deri 32 të Aktgjykimit të Sfiduar.

Gjykata e Shkallës së parë, sidoqoftë, nuk e kishte konstatuar si të vërtetuar se faktet e përshkruara më lart ishin kryer nga të Pandehurit siç ishin akuzuar në aktakuzë. Pas një analize të zgjeruar u vërtetua se protokollat e identifikimit të fotografive të të Pandehurve nga ana e

viktimës dhe disa dëshmitarëve nuk janë prova të besueshme dhe nuk mund të provojnë përfshirjen e tyre në dhunimin e V.K. Në sytë e Trupit Gjykues besueshmëria e këtyre provave zvogëlohet nga shumë faktorë: 1) nuk ka prova se si është bërë ky identifikim të fotografive me rreshtim në Tetor 1999; 2) fotokopjet e fotografive të zgjedhura nga viktima në rreshtimin e parë të fotografive përshkruan një person që nuk i ngjan të Pandehurit J.Dejanoviq; 3) Fakti se viktimës tashmë i janë treguar fotografia e J. Dejanoviqit më 1999, kishte kontaminuar mendjen e saj kështu që rezultatet e cilit do identifikimi të mëtutjeshëm do të ishin me besueshmëri të reduktuar. 4) procedurat e identifikimit të kryera më 2010 - 2012 janë të besueshmërisë së reduktuar për shkak të faktit se kishte kaluar kohe e gjatë qysh se kane ndodhur ato ngjarje të cilat janë nën hetime dhe kështu kujtimet e dëshmitarëve janë bërë të paqarta dhe dhe të shtremberuara; 5) viktima ka pasur rastin të diskutoj detajet e identitetit të të Pandehurit J. Dejanoviq me dëshmitarët, që e bënë identifikimin e mëvonshëm nga këta dëshmitarë të pabesueshëm; 6) besueshmëria e identifikimit të D. Bojkoviqit është së tepërmi e reduktuar nga fakti se asnjëri nga individët e paraqitur në fotografi nuk i ngjajnë në D.Bojkoviqin - ai ishte i vetmi person i vjetër në fotografi; 7) procedura e identifikimit në fjalë ishte e pabesueshme për shkak të disa mangësive procedurale.

Gjykata e Apelit nuk është e kenaqur me këto konkludime. Provat e parashtruara tek Gjykata e shkallës së parë janë ri vlerësuar me kujdes nga Gjykata e Apelit dhe janë gjetur të mjaftueshme të konkludohet përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit janë fajtor siç edhe akuzohen.

Në lidhje me procesin e rreshtimit të fotografive të bërë më 1999 nga hetuesi i policisë Sh. K., Gjykata e Apelit pajtohet me Prokurorët se konkludimet e gjykatës së shkallës së parë janë të papajtueshme në mes vete. Në anën tjetër Trupi Gjykues ngrit dyshimet në paanëshmërinë e S. K. duke konkluduar se S. K. në atë kohë veq se ishte duke dyshuar në mënyrë specifike tek J. D. për dhunimin e V. K. dhe kështu që për zgjedhja në mes fotografive ka mundur të ketë ndikuar. Në anën tjetër Gjykata pohon se personi i paraqitur në fotografi dhe i përzgjedhur nga viktima, nuk përmban ndonjë ngjashmëri të dalluar të J. Dejanoviqit. Këto dy konkludime janë kontradiktore. Nëse personi në ato dy fotografi është J. Dejanoviq- siç edhe duket të jete pajtuar Gjykata e Shkallës së Parë dhe i pandehuri nuk e ka kundërshtuar- atëherë fakti se dëshmitari e identifikoj personin e njejtë shumë vite më vonë në një fotografi shume më ndryshe dhe bile jo të ngjashme, nënkupton se ajo ishte shumë e bindur për identitetin e kryerësit dhe nuk ka mundur të jetë e influencuar nga asnjë referim i bërë asaj në vitin 1999. Gjykata e Apelit pajtohet sidoqoftë se identifikimi i parë është problematik, sespe nuk ka shënime për fotografitë të cilat iu desht viktimës që t'i përzgjedh dhe se si në fakt është bërë identifikimi. Kështu që, vetëm indetifikimi i J.Dejanoviqit në atë rast nuk do të mjaftonte që të hiqet çdo dyshim mbi indetitetin e kryersit. Konkludimet e Gjykatës Themelore në këtë çështje janë të vlefshme dhe Gjykata e Apelit pajtohet me to.

Sidoqoftë, duhet të kihet parasysh se viktima dhe disa dëshmitarë të tjerë e kanë njohur J. Dejanoviqin në raste të më vonshme. Gjykata e Apelit nuk pajtohet në këtë çështje me pikëveshtrimin e kufizuar të gjykatës se shkallës së parë se procesi i indetifikimit mundet të

behet në mënyrë të besueshme vetëm një herë. Besueshmëria e identifikimit mund të zvogëlohet nëse të njëjtat fotografi do të ishin treguar personit të njëjtë disa herë brenda një periudhe të shkurtë kohore- jo më shume se disa javë apo muaj në mes tyre. Kjo nuk qendron këtu, kur kompleti i fotografive nuk është i njëjtë dhe se koha në mes të procedurës së identifikimit është me vite (më tepër se 12 vite në këtë rast). Siç edhe e ka bërë me dije vet gjykata e shkallës së parë, memoria e njeriut turbullon apo shtrembëron detajet me kalimin e kohës. Kjo, me siguri nënkupton se do të ishte vështirë që një person të ndikohet nga një rast i vetëm i mëhershëm i shikimit të një fotografie të një personi të huaj për një periudhë të shkurtë kohore. Duke e marrë parasysh se viktimat si dhe dëshmitarët ishin në gjendje ta identifikojnë J.Dejanoviçin pa hezitim, edhe pas kalimit të sa e sa viteve, në mënyrë të konsiderueshme e rritë kredibilitetin e këtij identifikimi.

Gjykata e Apelit gjithashtu nuk pajtohet me dyshimet e ngritura nga Trupi Gjykes në lidhje me mundësinë se viktimat dhe dëshmitarët kishin diskutuar identitetin e kryesit. Ky shqetësim do të ishte i rëndësishëm vetëm në një situatë, kur kryesi mund të shikohej vizualisht nga dëshmitarët ose kur personi do të kishte ndonjë shenjë dalluese (si p.sh. shenjë të dukshme në lëkurë) që do t'a bënte të lehtë që dikush të bindej me fotografinë e "vërtetë" të kryesit. J.Dejanoviç nuk ka ndonjë shenjë të dallueshme e as që ka levizur në rrethin e viktimës apo dëshmitarëve para ose pasi që ka kryer krimin. Dy rastet e vetme kur personat që e kanë identifikuar atë gjatë procedurës, e kishin takuar J. Dejanoviçin ishin më 13 dhe 14 Prill 1999 , e kjo është një lidhje e direkte me veprën. Në anën tjetër duke e përjashtuar identifikimin e referuar që kishte ndodhur më 1999, i Pandehuri ishte identifikuar nga dëshmitarët para se të identifikohet nga viktimat. M. K. dhe I. G. i kanë identifikuar atë më 26 Prill 2012, N. K. më 16 Maj 2012 si dhe H. K. më 21 Maj 2012, përderisa V. K. viktimat, ka bërë identifikimin përmes fotografive tek më 17 Korrik 2012. Kështu që për mendimin e Gjykatës së Apelit nuk mund të thuhet se dëshmitarët ishin ndikuar nga identifikimi i bërë nga ana e viktimës, sepse deri më 17 Korrik 2012 ajo e kishte identifikuar të pandehurin një herë përmes fotografive jo të ngjajshme (ato të identifikuar më 1999), plotësisht tjera nga ato që i u treguan dëshmitarëve shumë vite më vonë. Pra, pretendimet se viktimat dhe dëshmitarët janë pajtuar tek më vonë mbi identitetin e të Pandehurit, në fakt përjashtohen për mendimin e Gjykatës së Apelit.

Ajo çfarë e shqetëson kritikën e Trupit Gjykes se personi i paraqitur viktimës në fotografi së bashku me fotografinë e D. Bojkoviçit , nuk ishin mjaftueshëm të ngjashëm për këtë të Pandehur, Gjykata e Apelit e pranon se kjo, deri diku do të mund të zvogëlonte besueshmërinë e identifikimit. Në një situatë të tillë është sidomos vendimtare që individi që e identifikon dikë ka dhënë përshkrimin e personit të identifikuar më parë para se ta përzgjedhë fotografinë. V. K. në të vërtetë e ka përshkruar të pandehurin, duke thënë në mes të tjerash se ai ishte një person i moqëm dhe si karakteristikë specifike personale se ai çalonte. Që të dy këto karakteristika aplikohen tek D. Bojkoviçit, siç edhe se Trupi Gjykes nuk kishte telashe që këtë ta konstatoj. Nuk ka asnjë shpjegim logjik, se pse V. K. do të përzgjedhte fotografinë e D. Bojkoviçit nga fotot e tjera , vetëm se ai ishte personi i vetëm i vjetër që i shte prezantuar atij. Ka

shumë pak gjasa se ajo do ta përzgjedhte fotografinë duke u bazuar vetëm në këtë tipar dhe që më vonë të ketë insistuar në personin që ajo në fakt kurrë në jetë nuk e kishte parë. Në lidhje me këtë, është shumë e rëndësishme që të vihet re, gjithashtu mbi faktin se kontakti në mes të D. Bojkoviqit dhe V. K. [REDACTED] kishte zgjatur për një kohë të caktuar dhe se ajo kishte rastin ta shikoj D. Bojkoviqin tërësisht. Kështu që Gjykata e Apelit pajtohet me atë se identifikimi i D. Bojkoviqit nga kompleti i rreshtimit të fotografive për sa i përket V. K. [REDACTED] është provë e besueshme.

Për sa i përket kritikave të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me vet kryerjen e procedurës së identifikimit, Prokurorët kanë pohuar se Gjykata Themelore kishte krijuar një kriter shtesë për procedurën e identifikimit të personave kur krahasohet me Nenin 233 të Ligjit mbi Procedurën Penale të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LPP të RSFJ-së) dhe Nenit 255 KPPK-së. Gjykata Themelore tha se në mënyrë që të jetë e besueshme, identifikimi i personave gjatë rreshtimit të fotografive, duhet që në mes tjerash të përmbushë edhe këto kërkesa:

- a) Fotografia e të dyshuarit duhet të përngajë me dukjen e këtij personi në kohën e kryerjes së veprës si dhe individët e tjerë të përdorur në përbëmjen e rreshtimit duhet të i ngjajnë përshkrimeve të bëra nga dëshmitari për kryersin.
- b) Fotografitë duhet të prezabtohen një nga një; dhe
- c) Personi që kryen procedurën e identifikimit duhet të mos ketë dijeni mbi identitetin e të dyshuarit.

Gjykata e Apelit tërheq vëmendjen se rreshtimi i fotografive që është relevant për këtë çështje ishte bërë më 1999 dhe 2010-2012. Rregullat procedurale për këtë veprim hetues citoheshin në Nenin 233 të CPP të RSFJ-së si dhe respektivisht Nenin 255 të KPRK-së. Siç edhe tregon teksti i thjeshtë normave të referuara, asnjëra nga to nuk i referohet kriterëve që kërkohen nga Gjykata Themelore në Aktgjykimin e Kontestuar.

Në Komentarin e ligjit Jugosllav mbi procedurën penale¹ sqarohet se para se të identifikohet dëshmitari duhet që së pari ta përshkruaj personin me sa më shumë detaje të mundshme (është sidomos me rëndësi të thuhet se, nëse ai apo ajo i njeh ata, disa karakteristika specifike), dhe pastaj të përfshijë këto përshkrime në procesverbal, dhe tek atëherë të behet identifikimi. Rregulla themelore e procesit të identifikimit është që të i prezantohet një numër i objekteve dhe personave tek dëshmitari, në mënyrë që të sigurohet një identifikim efikas, i cili mund të ketë vlerë procedurale. Është e domosdoshme të prezantohen së paku pesë persona apo objekte, përkrah atij që është objekt i identifikimit, kështu që dëshmitari duhet me doemos të kryej identifikimin. Nëse behet identifikimi i një personi, atëherë personat tjerë duhet që përafërsisht të ngjajnë në personin që duhet të identifikohet; është e domosdoshme që ata të kenë gjatësi të

¹ Shih Komentaret e Neneve të Ligjit të Procedurës Penale të Jugosllavisë. Libri III. 1998, edicioni i 3te, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Beograd, Koment mbi Nenin 233 nga Branko Pertiq.

njëjtë, ngjyrë floku të njëjtë (nëse i pandehuri ka flokë të zeza, atëherë personat biond apo ata pa flokë nuk mund të jenë pjesë e procesit të identifikimit etj), dhe se ata te jenë të veshur për afërsisht njëjtë, etj. Teksti i Nenit 255 të KPRK-së thjesht qon drejt të njëjtave konkludime me përjashtim se Neni 255 (3) ka edhe një kërkesë shtesë: obligimi që të udhëzohet dëshmitari se ai apo ajo nuk është nën çfarëdo obligimi që të përzgjedhin një objekt apo fotografi, dhe se është po aq me rëndësi që ai apo ajo nuk njih personin, objektin apo fotografinë siç edhe është po aq e rëndësishme të thotë që i njih.

Para se të identifikonin kryesit, viktimat si dhe dëshmitarët tjerë kanë dhënë deklaratat. Fakti që këto përshkrime nuk janë pjesë të protokollit të procedurës së identifikimit por janë të përfshira në protokollin e intervistës nuk mund të konstatohet se janë shkelje e normave të procesit penal. Është e vërtetë që kushti i përcaktuar nga neni 255 (3) i KPPK-së nuk është plotësuar në asnjërin prej identifikimeve në fjalë. Megjithatë, Gjykata e Apelit konstaton se kjo shkelje procedurale nuk është e një natyre të tillë, që në mënyrë automatike të shndërronte rezultatin e identifikimeve të pavlefshëm dhe të pabesueshëm. Në rastin në fjalë, nuk ekzistojnë rrethana që do ta shndërronin këtë shkelje në një shkelje të rëndë duke vënë në dyshim rezultatet e procedurës së identifikimit.

Prandaj, Gjykata e Apelit pajtohet me vlerësimin e ngritur në Ankesën e Prokurorit dhe konsideron që në të vërtetë Gjykata Themelore ka shkelur normat e procedurës penale duke kërkuar respektimin e procedurës së identifikimit me foto me kriteret që nuk parashihen në rregulloret procedurale relevante në kohën e zhvillimit të këtyre veprimeve hetimore.

Bazuar në shqyrtimet e mësipërme, Gjykata e Apelit konsideron që identifikimi i J. Dejanovic nga viktimat V. K. [REDAKTUAR] dhe dëshmitarët H. K. [REDAKTUAR], N. K. [REDAKTUAR], M. K. [REDAKTUAR] dhe I. G. [REDAKTUAR] dhe identifikimi i D. Bojkovic nga viktimat V. K. [REDAKTUAR] janë dëshmi të besueshme.

Gjykata e shkallës së parë, përveç mospranimit të validitetit dhe mjaftueshmërisë së identifikimit përmes paraqitjes së fotove, vuri në pah dhe theksoi një varg të mospërputhshmërive dhe kundërtënieve të gjetura në dëshmi të tjera duke e sjellë atë në dyshim të madh sa i përket identitetit të kryesve. Por Gjykata e Apelit është e një mendimi të ndryshëm. Identifikimet e kryesve janë vërtetuar nga dëshmi të rëndësishme indirekte. Në mesin e tyre janë deklaratat e dhëna nga dëshmitarët H. K. [REDAKTUAR], N. K. [REDAKTUAR], M. K. [REDAKTUAR] dhe I. Grajqevci dhe po ashtu edhe deklaratat e dhëna nga viktimat; dokumentacioni për një lëndim të vjetër në dorën e djathtë të J. Dejanovic; fakti që D. Bojkovic me të vërtetë çalon siq është theksuar nga viktimat; dhe që D. Bojkovic në të vërtetë e kupton dhe e flet shqipen. Gjykata e Apelit po ashtu thekson faktin e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë që J. Dejanovic në kohën e ngjarjeve në këtë hetim ka qenë i stacionuar në afëri të vendbanimit të viktimës. Identifikimi i suksesshëm i të dy të pandehurve së bashku me dëshmitë vërtetuese nuk lë dyshim të bazuar që J. Dejanovic dhe D. Bojkovic kanë pasur marrëdhënie seksuale me viktimën V. K. [REDAKTUAR] më 14 qershor 1999.

Gjykata e Apelit tash do të shqyrtojë të gjitha dëshmitë tjera dhe të merret me dyshimet e

ngritura nga gjykata e shkallës së parë për të përfunduar që veprat penale janë kryer nga të pandehurit.

Dëshmi rrethanore apo indirekte mund të cilësohen si dëshmi që provojnë një fakt apo një varg faktesh nga të cilat faktet në pyetje mund të vërtetohen përmes deduksionit. Pranueshmëria e dëshmive indirekte si mjet valid për të vërtetuar situatën faktike përtej dyshimit të bazuar nuk është e diskutueshme në saje të parimit të vlerësimit të lirë të dëshmive. Shkalla e sigurisë që jepet me këtë lloj të dëshmisë nuk është më e vogël se ajo që rezulton nga dëshmitë direkte sikurse dëshmia e dëshmitarit, në të cilën çështja vitale e kredibilitetit duhet të vlerësohet po ashtu duke u bazuar në kritere subjektive. Dëshmitë indirekte do të jenë të pranueshme si mjet për të provuar një fakt përtej çdo dyshimi të arsyeshëm kur plotësohen këto kritere: (1) duhet të ketë një shumësi të rrethanave nga e cilat nxirret deduksioni, (2) rrethanat duhet të mbështeten në dëshmi direkte, (3) rrethat duhet të ndërlidhen drejtpërdrejt me faktin që është nën demonstrim, (4) nuk guxon të ekzistojë rrethanë po aq e fuqishme që e mohon vërtetësinë e faktit të supozuar, (5) arsyetimi për deduksionin duhet të jetë racional dhe të mbështetet në rregullat e logjikës, përvojës dhe arsyes së shëndoshë.

Në rastin në shqyrtim, Gjykata e Apelit konstaton që ka dëshmi direkte të mbështetura dhe vërtetuara nga dëshmi indirekte dhe rrethanore të mjaftueshme për të përfunduar përtej dyshimit të bazuar që të pandehurin ishin kryesit e veprave penale. Ato janë si në vijim:

Në lidhje me fajësinë e të pandehurin Dejanovic

Aspekti i parë i rëndësishëm për ta ndriçuar është që i Pandehuri është parë nga shumë persona dhe për të periudhë të konsiderueshme kohore. Ky nuk ka qenë rast i një ngjarjeje që ka zgjatur disa sekonda dhe që është parë vetëm nga viktima. Në mbrëmjen e 14 prillit 1999 burri në uniformë që e rrëmbeu viktimën nga shtëpia e familjes së saj është parë nga katër persona të tjerë përveç asaj: M. K., H. K., M. K. dhe I. G. Dhe, duke pasur parasysh që ngjarjet e përshkruara nga këta dëshmitarë, është e qartë që prania e tij aty ka zgjatur disa minuta dhe ka lëvizur andaj pari në mënyrë që ia ka lejuar atij të shihej duke u sorollatur. Edhe pse viktima dhe familja e saj me siguri me siguri ishin në situatë të vështirë, duke u frikësuar se çka do të ndodhte, Paneli i Gjykatës së Apelit vë në pah njëkohësisht që është e arsyeshme dhe logjike të përfundohet se ata kanë qenë të vëmendshëm ndaj lëvizjeve të personit që ka paraqitur rrezik për ata.

Në anën tjetër, Gjykata e Apelit është e bindur nga dëshmitë se i Pandehuri po ashtu ka qenë i pranishëm në skenë në ditën e mëparshme. Jo vetëm sepse viktima e ka deklaruar këtë qart por sepse ky është konkluzioni i vetëm logjik dhe i shëndosh. Nuk do të ishte normale që personi që e ka rrëmbyer viktimën të shkonte të shtëpinë e familjes së saj vetëm nëse nuk e ka ditur se çka po e priste atje. Gjatë një konflikti të armatosur ky lloj i veprimeve zakonisht kryhet nga një grup i personave të armatosur. Më 13 prill një grup i burrave në uniformë shkuan te shtëpia e viktimës

për të urdhëruar tërheqjen e disa njerëzve që po kërkonin strehim aty dhe nuk mund të jetë koincidençë prania e një burri në uniformë në vendin e njëjtën ditën e nesërme. Kjo prani për dy ditë me radhë e forcon besueshmërinë e dëshimeve, sepse kryesi jo vetëm që është parë për një periudhë të konsiderueshme kohe, nga shumë persona, por ai është parë aty dy herë.

